

KONTROLLI DHE SHTYPJA SIPAS HISTORIKUT TË SIGURIMIT TË SHTETIT PËR QARKUN SHKODËR

Besnik Buçaj
(AIDSSH)

Të flasësh për persekutimin dhe viktimat e regjimit komunist në Shkodër do të duhej një kohë e gjatë, megjithatë kjo tematikë na shtyn që të japim kontributin tonë në drejtim të zbardhjes së të kaluarës, por edhe si homazh përkujtues për shpirtrat e të gjithë atyre që vuajtën regjimin komunist. Do mundohemi të japim sa më shumë në një rezymë faktesh e bilancesh sa më gjithëpërfshirëse, duke u mbështetur në burimet dokumentare të Sigurimit të Shtetit për qarkun e Shkodrës, e posaçërisht në “Historikun e Sigurimit të Shtetit për Qarkun Shkodër”.

Sqarojmë se përmes këtij dokumenti synojmë të pasqyrojmë historia e “lavdishme” e veprimtarisë së kësaj arme që ishte në duart e regjimit dhe në mbrojtje të tij, duke rrokur konkretisht periudhën 1941-1975. Në optikën e autoriteteve të kohës, edhe pse në vitin 1941 Shqipëria ishte praktikisht e pushtuar nga Italia dhe nuk bëhej fjalë për pushtetin komunist, “Arma e Sigurimit të Shtetit”, e cila po aq mirë mund të quhej “Arma e Sigurimit së Partisë”, thuhej se lindi dhe u krijua në rrethana po aq konspirative sa edhe vetë krijimi partisë komuniste. Partia doli nga mendjet dhe vullnetet e atyre që me krijimin e saj konceptuan njëkohësisht edhe nevojën për ta mbrojtur dhe siguruar atë në kërkimin e pushtetit, një mision që nga udhëheqësit komunistë është konsideruar si një “detyrë mbi detyrat”.

Arma e sigurimit paraqitet sikur ishte e konceptuar për të mbështetur luftën partizane, nëpërmjet akteve të diversionit, sabotimit, atentateve vrasëse, grumbullimit të informacioneve dhe përmbushjen e luftës propagandistike. Megjithatë, në realitet, vëmendja dhe përdorimi i saj kishin si objektiv kryesor kundërshtarët politikë, ideologjikë, ata të brendshëm dhe ata klasorë - një mision që mbeti konstant dhe konsekuent gjatë gjithë jetëgjatësisë së regjimit. Kjo vazhdimësi për ligji pretendimin se në këtë rast specifik vetë lindja e Partisë Komuniste të Shqipërisë u konsiderua edhe si lindja e vetë sigurisë.

Vlen të theksohet se në përmbajtjen e këtij materiali historik mbi organet e sigurimit, optika e vëzhgimit zhvendoset edhe përpara vitit 1941, duke na dhënë përshkrime sesi Shkodra përbënte për ta një “habitat reaksionar”, kohë përpara se të shfaqej në horizont murtaja e komunizmit. Duke pasur parasysh këtë, Shkodrën e bënte “habitat reaksionar” edhe fakti i të qenit një qytet i hapur ndaj botës, kjo edhe për shkak të pranisë së përfaqësive të huaja konsullore dhe diplomatike.

Nisur nga volumi i materialit dhe nga nevoja për ta përmbledhur, epoka e persekutimit dhe e shtypjes në Qarkun Shkodër mund të periodizohet në disa shtylla, ku figuron të jetë përqendruar vëmendja në punën dhe veprimtarinë e Sigurimit.

1. *Së pari*: “Veprimtaria e diversionit dhe atentatet ndaj eksponentëve të konsideruar armiq gjatë okupimit, si dhe eliminimet e brendshme, apo brenda llojit”;
 2. *Së dyti*: “Shtypja e rezistencës së armatosur në periudhat (1944-1948) dhe (1948-1955)”;
 3. *Së treti*: “Shtypja politike nëpërmjet luftës, ndaj grupeve dhe organizatave reaksionare, për përmbysjen e pushtetit popullor (1945-1975)”.
 4. *Së katërti*: “Shtypja dhe kontrolli politik nëpërmjet “agjitacion-propagandës”, deri në përmbysjen e regjimit (1960-1991).
- Duhet theksuar se në fibrën e qëndresës dhe të rezistencës që prek e përfshin këto shtylla të periodizuara, një vend të veçantë e thelbësor, por edhe nderi, ka kleri dhe sidomos kleri katolik, i cili përgjatë çdo faze e epoke të shtypjes akuzohej me tone tejet agresive e armiqësore, si një ndër faktorët kryesorë të kryeneçësisë ndaj regjimit diktatorial-komunist.

Nisim nga epoka e rezistencës së armatosur. Menjëherë pas futjes së forcave komuniste në Shkodër, më 28 nëntor 1944 dhe në vijim të përpjekjeve për instalimin e pushtetit të tyre, - kjo në bashkëpunim edhe me jugosllavët, - Shkodra u konsiderua nga autoritetet e kohës si “kryezona e reaksionit”, duke vlerësuar se situata atje ishte mjaft e komplikuar, për shkak edhe të mungesës së influencës në këtë zonë. Në kushte të tilla Shkodra u administrua në formën e një qarku me karakter ushtarak, në juridiksion të të cilit përfshihej edhe Malësia e Madhe e Kopliku, Puka, Dukagjini, Lezha, Mirdita, të cilave shpejt iu bashkëngjitën edhe qarqet Kukës, Dibër, pra krejt veriu.

Për administrimin e zonës ishin instaluar të ashtuquajturat “Seksionet e Mbrojtjes së Popullit” (SEMP-i) në vartësi të “Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit”. Këto formacione ishin, sa ushtarake, aq edhe një farë policie sekrete, të cilët duhej të vepronin në jo vetëm në rrugë të hapur, por dhe agjenturore, me mision mbajtjen nën kontroll të popullsisë dhe identifikimin e çdo kundërshtari dhe goditjen e tij, si parakusht për ngritjen dhe instalimin e autoriteteve dhe organeve të reja komuniste.

Të tilla formacione ushtarake, brenda të cilave vepronin organet e Sigurimit, u ngritën në lagjet dhe fshatrat e Shkodrës dhe konkretisht në lagjet Kiras, Rus, Maxhar, Ballaban, Pazari i Vjetër, Perash, Dugajat e Reja, si dhe në fshatrat; Mjedë (Vau i Dejës), Gur i Zi, Bushat, Velipojë, Oblikë, Vrakë, Mes, Shllak, Dajç i Bregut të Bunës, Shirokë, Zogaj. Nga ana tjetër, për autoritetet komuniste në Qarkun Shkodër vepronin “bandat reaksionare”, apo edhe “të arratisurit”, të cilat vlerësoheshin se ekzistonin në rreth 26 grupe rezistence, me përbërje, nga 15, deri në 173 persona dhe ku spikatin emrat e drejtuesve si të Prek Calit, Llesh Marashit e Jup Kazazit. Sprova e parë e

përplasjeve të armatosura do të shënohet gjatë janarit të vitit 1945. Me urdhër të liderit komunist, u vendos që qarku i Shkodrës dhe rrethinat të shkeleshin me “forca partizane”, duke provuar edhe një herë se ata nuk quanin çlirim largimin e ushtrive të huaja apo pushtuese, por largimin e çdo autoriteti që nuk kontrollohej nga ata. Për këtë u urdhërua Batalioni I i Brigadës I, që të pushtonte me forcë gjithë krahinat që përfshinte qarku i Shkodrës, për të zhdukur e shtypur çdo formacion apo kundërshti ndaj pushtetit komunist. Në zbatim të direktivave ushtarake, forcat komuniste mësynë Vermoshin si zonë strategjike, dhe ku më 15 janar 1945 ndeshën me luftëtarët e Preng Calit, i cili me rreth 300 malësorë i priti forcat komuniste tek “Ura e Tamarës”, duke i thyer ato dhe shkaktuar vrasjen e 37 personave nga forcat e ndjekjes, si dhe të komandantit të tyre.

Ky dështim i acaroi autoritetet komuniste, të cilat urdhëruan një operacion ushtarak në shkallë të gjerë, me Vendim të Komitetit Qendror të PKSH-së, ku përveç qarkut të Shkodrës të përfshiheshin pothuaj të gjitha qarqet e veriut të vendit e kjo me qëllim zhdukjen e forcave reaksionare dhe forcimin e pushtetit popullor. Në krye të këtij operacioni ushtarak në shkallë të gjerë, u vendos Mehmet Shehu. Në datën 28 janar 1945 shpallet gjendja e jashtëzakonshme dhe filloi operacioni që nisi nga Shkodra, e cila u nda në zona kontrolli dhe ku patrullat partizane e ato të SEMP-it ushtronin kontrolle të imtësishme në çdo lagje e rrugë të qytetit, duke kryer edhe arrestimet mbi bazën e listave të paracaktuara. Në zbatim të kësaj, nga lista me 240 persona u arrestuan 120 syresh. Ky operacion, të cilin ata nuk e fshinin se ishte i formës së reprezaljeve, sukseset e veta brenda qytetit i arriti falë formave dhe metodave të tilla. Pas kryerjes së spastrimeve dhe reprezaljeve në qytet, u kalua në fazën e dytë të operacionit dhe konkretisht në shtypjen e forcave antikomuniste të përqendruara në Malësinë e Madhe dhe në fshatrat e Shkodrës. Kjo përfshinte sulmin në tre drejtime. Drejtimi i parë, zona e Shkrelit. Drejtimi i dytë, zona e Dedajve. Drejtimi i tretë, kalimi i forcave në territorin e shtetit jugosllav, për në zonën e Tuzit dhe në bashkëpunim me forcat jugosllave t’u dëlnin nga prapa shpine forcave të Preng Calit. Operacioni filloi me 5 shkurt 1945 dhe në të u angazhuan partizanë nga batalionet e plotë tri Brigadave, ku përfshiheshin; Brigada I Sulmuese, ajo XXIII dhe ajo XXIV. Në datën 17 shkurt, forcat e fundit të rezistencës së udhëhequr nga Prek Cali mbetën të rrethuara në shpellën e Vuklit, prej nga u detyruan të dorëzoheshin dhe me dorëzimin e tyre kryengritja e rezistenca ra e u shtyp, por jo përfundimisht.

Sipas vlerësimit të autoriteteve komuniste, ky operacion pati si bilanc vrasjen e 44 kryengritësve dhe kapjen e 18 krerëve, të cilët më pas do të dënoheshin me pushkatim nga gjyqet speciale, ndërsa nga ana e forcave partizane citohet të jenë vrarë 7 partizanë. Gjithsesi, kjo nuk krijoi një shtrat të sigurt për autoritet komuniste. Pavarësisht nga spastrimi dhe egërsia e ushtruar gjatë atij operacioni, situata në Malësinë e Madhe mbeti e nderë dhe “reaksioni” - siç ata i etiketonin antikomunistët - nuk u shkëlqy plotësisht.

- Pas kryengritjeve që përfshinë Kelmendin dhe Koplikun, në fund të vitit 1944 dhe fillimin e vitit 1945, radha i erdhi Kryengritjes së Postribës, në vitin 1946.

Sipas vlerësimit të organeve komuniste të kohës, në aspektin e armikut të jashtëm, për këtë kryengritje ishin të interesuar dhe u qëndronin nga pas anglo-amerikanët dhe Vatikani. Ndërsa në planin e armikut të brendshëm pas saj qëndronin “të arratisurit” (një emërtim që përdorej për t’iu referuar grupeve të rezistencës) dhe “kleri katolik”. Në këndvështrimin të autoriteteve komuniste, në këtë kohë del në skenë edhe “grupi i deputetëve opozitarë”, i dalë nga zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945. Sipas saj, në shkurt të vitit 1946, përfaqësues të grupit të deputeteve kanë zhvilluar një takim të fshehtë me kryetarin e misionit amerikan Jakobs, për të diskutuar për kryengritjen dhe se komploti për rrëzimin e pushtetit popullor kishte filluar qysh përpara zgjedhjeve, për çka ishte planifikuar që gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të propagandohej në mënyrë që populli të mos e hidhte votën tek kutia e kandidatëve të “Frontit Popullor”, por tek kutia bosh që u takonte atyre përfaqësuesve të cilët do të dilnin si opozitarë. Konturet e kryengritjes, sipas vlerësimit të autoriteteve të kohës, bazoheshin në skemën klasike “kryengritje si shkak për ndërhyrje ushtarake anglo-amerikane”, pa harruar këtu edhe sigurimin e përkrahjes së Vatikanit për këtë kryengritje.

Kryengritja pati si epiqendër Postribën, aty ku vepronin forcat e Jup Kazazit, i cili në këtë periudhë konsiderohej nga autoritetet e kohës si kreu kryesor i reaksionit. Kryengritja filloi më 9 shtator 1946 dhe kryengritësit dhe forcat e rezistencës (rreth 450 vetë) arritën të marrin Koplikun e të rrethojnë Shkodrën në tre drejtime, por pa arritur ta shtien në dorë, duke bërë që më pas autoritetet komuniste t’i shpërbëjnë dora-dorës forcat kryengritëse. Sipas dokumenteve në fjalë, baza ku qëndronte Jup Kazazi dhe nga ku ai drejtonte kryengritjen, arrihet të identifikohet se gjendej brenda qytetit të Shkodrës, konkretisht në shtëpinë e çifligarit Rifat Beg Bushati, e cila u rrethua nga forcat e ndjekjes 15 shtator të 1946, çka bëri që Jup Kazazi të kryente vetëvrasje për të mos rënë në dorën e autoriteteve komuniste.

Si bilanc të kryengritjes së Postribës, në dokumentet e Sigurimit të Shtetit pasqyrohet fakti i vrasjes së 33 kryengritësve, i tetë të tjerëve të kapur gjallë, por të vrarë pa gjyq, si dhe i dorëzimit të 200 të tjerëve, të cilët u gjykuan dhe u dënuan sipas gjyqeve ushtarake.

Sipas këndvështrimin analitik, për autoritetet komuniste, dalja e situatës jashtë kontrollit dhe pamundësia për ta shtrirë sovranitetin mbi këto territore kishte ndodhur si pasojë e një pune jo të mirë të organeve politiko-administrative dhe ushtarake, të atyre të Sigurimit të Shtetit, si dhe tradhtisë, - siç e quajnë ata, - të mjaft eksponentëve të të gjitha niveleve të pushtetit, të cilët akuzoheshin dhe fajësoheshin se kishin mbajtur qëndrime toleruese, neglizhuese e deri bashkëpunuese me krerët e reaksionit dhe madje në disa raste duke u hedhur në anën e tyre e duke dalë në arrati.

Në tërësinë e lëvizjeve e të rezistencës së armatosur, në një bilanc më të përgjithshëm vetëm për Qarkun e Shkodrës, autoritetet e kohës flasin për një total prej rreth 26 grupesh, me një numër prej 738 kryengritësish, nga të cilët 608 u asgjësuan dhe 130 ngelën në arrati.

Ndërsa në tërësi, në të gjitha qarqet ku u shtri operacioni në shkallë të gjerë, Sigurimi numëronte 95 grupe dhe një total prej 1200 kryengritësish. Shtypjes ushtarake i shtoheshin edhe 32 grupe “diversantësh”, - siç i quanin, - me nga 3-4 persona, të cilët kanë vepruar për përmbysjen e regjimit në periudhën 1948-1955.

➤ **Shtypja politike nëpërmjet luftës ndaj grupeve dhe organizatave rreksionare për përmbysjen e pushtetit popullor.**

Pas shtypjes ushtarake, autoritetet komuniste e përqendruan vëmendjen në shtypjen politike, në nivel të organizatave apo grupeve kundërshtarë, siç i vlerësonin apo i nxirrnin ata.

Për efekt kohe është e pamundur të citohen të gjitha organizatat e grupet, përbërja dhe qëllimi i tyre, por një përmbledhje të tyre, sipas numrit, natyrës së veprimtarisë dhe akuzave që u atribuoheshin, mund ta citojmë me një përmbledhje si vijon:

- Në total, shtypja politike që përfshin vitet 1945-1975, përmbledh:
 - Goditjen e një entiteti grupor të përbërë nga rreth 70 grupe e organizata, me përbërje, nga tre, deri në pesë, persona për grup, e në disa raste edhe më shumë. Këtu përfshihen edhe ata që i përkasin kategorisë së të “riatdhesuarve”, apo edhe ata të akuzuar për “sabotim në ekonomi”, por që u ngarkoheshin edhe akuza politike, të cilat, të përkthyer në numra personash dhe familjarë të tyre, arrinin në qindra e mijëra persona të prekur nga persekutimi komunist.
 - Nisur nga metoda. Zakonisht kjo bazohej tek profili i njohur i personit, si politikisht i pabesueshëm ose kundërshtar politik. Kur mungonin faktet komprometuese, siç i vlerësonte Sigurimi, përdorej i ashtuquajti kombinacion; një lojë e Sigurimit me bashkëpunëtorë, nëpërmjet të cilëve krijonte e stiste situata apo kontakte komprometuese me personat që do të goditeshin, mbi të cilat më pas ndërtonte ngrehinën e fabulës agjenturiale. Më pas goditej grupi, por në shumë raste një nga të shënjuarit lihej i paprekur, si rezervë, që në një kohë të mëvonshme, përmes tij të goditej tjetër një “grup” i krijuar. Pra, një punë zinxhir dhe e metodifikuar, ku tërësia e fakteve dhe e provave, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, lë të kuptojë se në pjesën dërmuese kemi të bëjmë me grupe imagjinare ose, së paku, të ekzagjeruar, me qëllim goditjen e çdokujt që dyshohej apo njihej si kundërshtar i regjimit, pavarësisht se e shfaqte apo jo ai.
 - Sipas natyrës juridike të akuzës, këtyre grupeve u ngarkohej akuza bazë “Për përmbysjen e pushtetit popullor”, të cilën do ta arrinin nëpërmjet:
 1. *Organizatave të karakterit politik - kundërrevolucionare.*
 2. *Organizata të karakterit “intelektual e rinor”.*
 3. *Organizata të karakterit klerikal ose të besimit.*
 4. *Organizata kundërrevolucionare brenda radhëve të vetë pushtetit.*

Referuar shembujve tipikë,

- Si organizata të karakterit politik-kundërrevolucionar, veçojmë:

- Organizata “Bashkimi Shqiptar”, themeluar me 17 shkurt 1945. - ----
- Organizata “Demokristiane” (Partia Demokristiane). Vlerësohej se ishte krijuar më herët, qysh nga viti 1943. Që të dyja këto organizata akuzoheshin se kishin luajtur rrol vendimtar në lëvizjet e armatosura.

Si organizata të karakterit “intelektual e rinor”, veçojmë:

- “Grupi i të rinjve - Përpyjekja Shqiptare” (1947-1948), me projektues dhe frymëzues, Prof. Qemal Draçinin, Prof. Paulin Palin, Prof. Sami Repishtin etj.
- “Grupi i Gjinnazistëve” (1946-1947), me organizator Pjetër Rasha e Lula Doragjati. - --
- “Grupi i dytë i Gjinnazistëve” (1947), me drejtues kryesorë Prof. Abdyl Rusin, Ruzhdi Çobën, Thabit Rusni, Xhavit dhe Oso Qukun, etj.
- “Grupi Liria” (të rinjtë e gjinnazit në Shkodër - 1951), ku spikat emri i Et’hem Bakallës, nënkryetar i organizatës “Përpyjekja Shqiptare”, tashmë arkëtar i grupit Liria.
- “Grupi armiqësor i “Të rinjve reaksionarë” (1957). Akuzoheshin për arratisje. -
- “Grupi armiqësor i të rinjve Liceist” (1957). Referimi është ndaj një grupi të rinjsh që ndiqnin studimet në Liceun Artistik në Tiranë dhe në të cilin, përveç disa studenteve shkodranë, përfshiheshin dhe studentë nga Tirana, Elbasani dhe Korça. Objekti i veprimtarisë së tyre lidhej me agjitacion e propagandë, tentim arratisje, hedhje traktesh.
- Vëllezërit Injac dhe Viktor Kujunxhia (Kujxhia) (1957), që akuzoheshin për arratisje.

➤ Organizata të karakterit klerikal ose të besimit, si p.sh.:

- “Grupi i Murgeshave” (1947), për këtë grup akuzohej edhe Ana Daja. Veprimtaria armiqësore e grupit përqendrohej në ndjekjen dhe mbrojtjen e parimeve fetare, pjesëmarrjen në ritet fetare, si lutjet, kungimet, rrëfimet dhe kremtimet, paçka se feja ende nuk ishte ndaluar me ligj.
 - “Grupi i Dom Ded Malaj”. Ishte akuzuar dhe dënuar më herët si pjesë e kryengritjes së Postribës së 9 shtatorit 1946, ndërkohë që i vëllai, Nikoll Malaj, ishte dënuar me vdekje.
 - “Grupi i Dom Engjëll Kovaçit”. Si kundërshtar ndaj qëllimeve politike për kontrollin e klerit nga regjimi. - ---
 - “Grupi i Imzot Frano Gjinajt. (vitet 1950). Veprimtaria, propagandë rreth fesë dhe besimit.
 - “Grupi i Patër Rrok Gurashii” (1956). Akuzohej posaçërisht se mbante lidhje me Vatikanin dhe e informonte atë mbi gjendjen e klerit në Shqipëri.
- “Mark Gjini”. Akuzohej për lidhje me organizatën “Shqipëria e Lirë” (vitet 1960); një organizatë me karakter bamirësie.

➤ **Organizata kundërrevolucionare brenda radhëve të vetë pushtetit, si p.sh.:**

- “Grupi brenda organeve të sigurimit të shtetit, i udhëhequr nga Pjerin Këçira” (1948).
- “Grupi i oficerëve, i udhëhequr nga Gjeto Keqi” (1948).
- “Rezidentura e Haxhi Hajdarit” (vitet 60). Ish-deputet dhe zyrtar i regjimit, që kishte kundërshtuar politikat e administrimit në Shkodër..

“Grupi armiqësor “Rrëshqitja” (1974), që ishte më interesante nga këta më lart. Për këtë grup akuzoheshin disa oficerë, të cilët do të përmbysnin pushtetin popullor me 200 persona, duke sulmuar institucionet në Shkodër, apo bllokun e vilave të udhëheqjes në Tiranë, ose në rast dështimi të arratiseshin!

Niveli arsimor e kulturor i kuadrove të sigurimit të shtetit në Qarkun Shkodër, për periudhë 1948-1955, ishte si vijon: 30% me arsim fillor, 62% me arsim 7-vjeçar. 8% me arsim të mesëm dh 0% me arsim të lartë.

➤ **Aspektet e luftës së klasave dhe kontrollit të pakënaqësive në fushën e ekonomisë.**

Në këtë aspekt është interesant fakti që regjimi i atëhershëm nuk njihte dështime lidhur me dogmat e organizimit të punës dhe të ekonomisë së re në tërësi. Ky pushtet shihte dhe i vlerësonte si shfaqje të përpjekjeve për të fshehur dhe kamufluar veprimtarinë armiqësore të tyre format dhe përpjekjet e njerëzve për t’u përshtatur me format e organizimit të ri ekonomiko-shoqëror, veçanërisht të atyre njerëzve që ishin stigmatizuar si “kulakë”, “mikroborgjezë” e “tregtarë”, për të mos folur për “çifligarët apo bejlerët” dhe të deklasuarit në tërësi. Sipas Sigurimit, gjykoheshin si të tilla, posaçërisht këto forma:

- Ndërrimi i vendbanimeve dhe i mbiemrave, si dhe largimi nga fshati, për t’u punësuar në objektet ekonomike dhe më pas ngritja e vendbanimit në këto të fundit.
- Kalimi i kulakëve (fshatarëve të pasur) nga rrethet tjera për në Shkodër dhe anasjelltas, si dhe punësimi i tyre në ndërmarrje ekonomike.

Që të dyja këto forma të veprimtarive të kryera nga këta njerëz, në fakt ishin kryekëput pasoja të politikave ekonomike, të shtetëzimit dhe kolektivizimit, apo edhe të deklasimit politik që ndiqte regjimi, gjë që i detyronte këto shtresa dhe njerëzit në tërësi, që thjeshte të përshtateshin me këto ndryshime. Nisur nga një statistikë që jepet nga vetë organet e Sigurimit të Shtetit lidhur me personat që ushtronin veprimtari armiqësore në ekonominë socialiste dhe që ishin goditur vetëm për periudhën 1945-1959, rezulton se:

- 28% e tyre ishin anëtarë dhe kandidatë partie, ndërsa 75% ishin nga shtresat e varfra dhe të mesme.
- Në vitin 1959, nga 26 të arrestuarit për krime në ekonomi, 9 syresh vinin nga shtresa e varfër dhe 17 nga shtresa e mesme.

Një fakt ironik ky për retorikën e luftës së klasave.

Gjatë periudhës së viteve 1956-1960, kohë që korrespondon me ftohjen e marrëdhënieve me BRSS-në dhe afrimin e kësaj të fundit me Perëndimin dhe Jugosllavinë, autoritetet komuniste duket se e ripërqendruan vëmendjen e tyre drejtë zonave kufitare, ku bënte pjesë edhe qarku i Shkodrës, duke vënë në optikën e goditjes tre elementë, siç figuron nga historiku i Sigurimit të Shtetit:

1. Popullsinë e zonave kufitare;

2. Spastrimin nga radhët e veta të personave që konsideroheshin si pro linjës së re sovjetike, ose, siç u quajtën, trockistët; 3. Klerin (besimin).

Sipas elementëve të mësipërm, organet e Sigurimit e shtrinin kontrollin si vijon:

Ndjekja/survejimi në lidhje me ndikimin jugosllav, por edhe si të lidhur me jugosllavët.

- 1.436 persona në qytet dhe 1.988, në nivel qarku, vëzhgoheshin si të ndikuar nga Jugosllavia.
- 167 persona të dyshuar si të lidhur me legatën jugosllave.
 - 6 prej tyre ndiqeshin në 2A.
 - 16 prej tyre ndiqeshin në 2B.
- 131 persona si të lidhur me të postën jugosllave.
 - 2 prej tyre ndiqeshin në përpunim paraprak.
- 18 emigrantë të ardhur nga Jugosllavia (kryesisht shqiptarë).

Ndjekja/survejimi brenda partisë, viti 1960.

- 1.025 anëtarë partie të përjashtuar.
- 178 prej tyre për motive politike.
- 11 në përpunim aktiv.
- 3 në përpunim paraprak.

Për survejimin brenda radhëve të vetë anëtarëve të partisë, Sigurimi në këtë kohë kishte të dedikuar:

- 6 agjentë dhe
- 13 informatorë, (gjë e cila vlerësohej si e pamjaftueshme).

Ndjekja/survejimi i kulakëve dhe i familjeve fshatare/kufitare (1960).

110 familje kulake, të cilat ndiqeshin për veprimtari që lidhet me kundërshtimin e kolektivizimit dhe kooperativizmit, si dhe arratisjet si veprimtari armiqësore, nga ku:
175 fshatarë ndiqeshin në përpunim 2A.
421 fshatarë ndiqeshin në përpunim 2B.
10 fshatarë ndiqeshin në përpunim paraprak.

Mbulimi i fshatrave, sipas numrit të bashkëpunëtorëve të Sigurimit, pasqyrohej si vijon:

78 fshatra mbuloheshin me nga 3 bashkëpunëtorë secili.
42 fshatra mbuloheshin me nga 2 bashkëpunëtorë secili.
50 fshatra mbuloheshin me nga 1 bashkëpunëtorë secili.
9 fshatra mbuloheshin me 0 bashkëpunëtorë.

Sipas Sigurimit, veprimtaria armiqësore, sipas ndikimit të jashtëm vinte nëpërmjet radiotelevizionit dhe emisioneve në gjuhën shqipe, nëpërmjet të cilave tek populli dhe rinia propagandohej jeta e mirë që bëhej në Jugosllavi dhe vendet e tjera, gjë e cila nxiste arratisjet.

Struktura organike e Sigurimit për vitin 1960 përfshinte:

Për qytetin.	Për fshatrat.
45 agjentë.	57 agjentë.

245 informatorë.	410 informatorë.
25 rezidentë.	35 rezidentë.
41 strehues.	12 strehues.

➤ **Shtypja politike nëpërmjet luftës ndaj “agjitacion-propagandës” e deri në përmbysjen e regjimit (1960-1991).**

Krahas luftës ndaj armiqve të regjimit, që në këndvështrimin e Sigurimit ishin kundërshtarë në formën e grupeve, optika e kësaj lufte u përqendrua tek individit dhe procedimi në popull për “agjitacione propagandë”, një vepër penale kjo që përfshinte çdo lloj forme mendimi, veprimi, mënyre jetese dhe perceptimi emocional mbi jetën e përditshme, kulturën, artin dhe muzikën, apo dhe paraqitjen e jashtme të individit, që ishte e papëlqyeshme për regjimin.

Këtu është momenti që të bëhet një sqarim i shkurtër juridik përse organet e Sigurimit për këtë periudhë i dhanë përparësi të shprehur luftës për shtypjen e armiqve të pushtetit, në formën e akuzës për agjitacione e propagandë, ndërkohë që kjo vepër penale ishte inkadruar në kodin penal qysh në vitin 1952, ku në nenin 73 të të cilit përcaktohej se” “Çdo propagandë ose agjitacion që ka për qëllim të dobësojë ose të rrezikojë pushtetin popullor, dënohet me heqje lirie jo më pak se tre vjet”!

Në fakt, kjo siç duket lidhet me disa arsye, të cilat janë, sa praktike, aq dhe politiko-ideologjike, dhe që dalin nga një këndvështrim retrospektiv, të tilla si:

- Arsyet praktike:

Së pari, lufta ndaj grupeve të armatosura, si dhe kundërshtarëve politikë të akuzuar se kryenin veprimtari të organizuar kundër pushtetit, nuk e bënte të volitshme përdorimin e një akuze të tillë, e cila, deri në ndryshimet e kodit penal në vitin 1977, nuk e përmbante parashikimin e dënimit kapital, ndërkohë që regjimit i duhej të përdorte aplikimin e veprave të tjera penale me fuqi kapitale mbi jetën e të akuzuarve, si mënyrë kjo që regjimi t’i lante hesapet me kundërshtarët politikë, - siç thoshin ata.

Së dyti, pakësimi i kategorisë së rrezikshme të grupeve të organizuara dhe dalja në pah e faktit se kundërshtitë apo shfaqjet e pakënaqësive shoqërore ishin të nivelit individual. Për organet e Sigurimit bëhej i domosdoshëm tashmë përqendrimi i vëmendjes pikërisht në përdorimin dhe aplikimin e veprës penale të agjitacion-propagandës. Kjo vepër penale do ashpërsohej në kodin penal të vitit 1977, me nenin e famshëm 55, ku kjo dispozitë do përfshinte dënimin me vdekje.

- Arsyet politiko-ideologjike:

Këto arsye ishin me përcaktuese në lidhje me rëndësinë e veprës penale të agjitacion-propagandës, sepse:

Së pari, nëpërmjet kësaj vepre penale plotësohej një vakum ekzistues i raporteve ligjore dhe i harmonizimit juridiko-ideologjik të karakterit konstitucional të regjimit, për mbrojtjen apo sanksionimin e shtyllave të tija ideologjike, siç ishte edhe mbrojtja e ideologjisë së vetme

sunduese, marksizëm-leninizmit. Kjo ndodhte në çdo fushë të organizimit shoqëror, politik, ekonomik, kulturor, arsimor, artistik dhe në fund edhe shpirtëror e që madje e zëvendësonte besimin; mbrojtjen e partisë-shtet dhe të sistemit njëpartiak; mbrojtjen e kultit të udhëheqësit (kulti i individit); mbrojtjen e hiper izolacionizmit shqiptar (ky i fundit jo vetëm në kuptimin e marrëdhënieve ekonomiko-politike me botën, por dhe në aspektin social-kulturor dhe, më e rëndësishmja nga të gjitha e që do rezultonte e një niveli më të lartë, mbrojtjen dhe vijimësinë e pushtetit.

Pra, mbrojtja e sanksionimeve ideologjike e kushtetuese kishte nevojë të harmonizohej me kuadrin hierarkik ligjor, duke depërtuar deri në bazë, pra deri në shkallën më të ultë të hierarkisë së ligjeve, çka arrihej pikërisht nëpërmjet rregullimit kodifikues, ashpërsimit të normës dhe kapilarizimit të përdorimit të saj në shoqëri.

Së dyti, në nivelin e zbatueshmërisë, vepra penale e agjitacion-propagandës e kapërcente problemin e raporteve konkurruese ndërmjet normave të karakterit procedural, me ato materiale, dhe në raport me zbatimin e politikës penale në procesin gjyqësor, sipas parimit të “drejtësisë popullore apo edhe të diktaturës së proletariatit”, i cili duhet thënë se ishte i “tipit inkuizitor”, sipas doktrinës e cila prevalonte mbi arsyen apo racionalizmin juridik të së drejtës dhe filozofisë së të drejtës.

Prandaj, në këtë kuptim, parimet dhe elementët juridiko-formalë mbi të cilët përcaktohet dhe analizohet përgjegjësia penale, si dhe figura e veprës penale, humbisnin juridikisht në favor të akuzës, e cila, edhe për shkak të evazivitetit gjuhësor të asaj norme, vlerësohej nga organet gjyqësore dhe ligjzbatuese vetëm në aspektin e aparencës apo të identifikimit të saj, e jo të përmbajtjes apo të faktimit real të raporteve konkrete të të akuzuarit me këtë vepër penale. Në rastin konkret pasoja supozohej apriori si e një lloj rrethane të rëndë e në kontekst krejtësisht ideologjiko-doktrinar, duke çuar në atë që në raportet veprim-pasojë, ose shkak-pasojë, gjithçka abstragohej brenda një absurditeti të atillë, saqë njerëzit edhe nuk e kuptonin se çfarë, apo cila ishte lista e plotë e veprimeve, shfaqjeve apo mendimeve që nuk duhej t’i kryenin apo t’i shkelnin, për të mos rënë në pozitën e agjitacionit dhe propagandës.

Pra për ta thënë edhe më shkurt, kjo vepër penale u aplikua në formën e dënimit të shfaqjes, kjo edhe në mungesë të veprimit/qëllimit, pa qenë e nevojshme të provohej pasoja që lidhej me objektin e veprës penale dhe, më keq se kaq, dënonte mendimin, pa qenë nevoja të provohej shfaqja apo prania e veprimit të viktimës së pandehur.

Shprehjet dhe akuzat si: “në mendjen e personit kanë lindur mendime mikroborgjeze, apo të huaja”, ose edhe më të lehta se kaq, siç është “shfaqja e mendimeve mikroborgjeze apo të huaja”, si dhe rastet me shfaqjen e veshjeve të “rrezikshme” apo të paraqitjes në kundërshtim me njëtrajtshmërinë komuniste, të cilat nuk i shpëtonin syrit vigjilent të Sigurimit, në optikën e të cilit dukeshin si agjitacion e propagandë, shquhen si kuintesenca e asaj çfarë përfaqësonte krejt sistemi.

Në këtë mënyrë, nëpërmjet kësaj vepre penale regjimi kërkonte të garantonte krijimin e “njeriut e ri”, produkt i doktrinës dhe pikërisht ashtu siç ai dëshironte ta shihte, larg vullnetit individual e të pavarur: pa sy që të shikojë, pa veshë që të dëgjojë, pa mendje që të mendojë dhe kjo sepse çdo gjë që duhej parë, çdo gjë që duhej dëgjuar dhe çdo gjë që duhej menduar, duhej të përputhej me vizionin e partisë-shtet, në krye të së cilës vigjilonte udhëheqësi. Nuk është për t’u çuditur që tashmë edhe ëndrrat e njerëzve gjatë gjumit përbënin agjitacion e propagandë, kur ato binin ndesh me shijet dhe vijën e pushtetit dhe kjo jo e thënë si një figurë letrare, por e provuar nga histori të vërteta, të cilat nuk mund të kenë ndodhur kund tjetër, veçse në Shqipërinë që kishte arritur në zenitin e diktaturës, totalitarizmin.

Në kushte të tilla regjimi kërkonte “asketizmin” e gjithanshëm të individit në shoqëri (dhe të shoqërisë në mënyrë totale), i cili duhej ta ndjente dhe ta jetonte doktrinën ideologjike si një “murg politik” i mbyllur në “manastirin ideologjik”, çka në fakt e ktheu vendin në një “morg” ku vritej çdo lloj lirie, mendimi, besimi, si dhe çdo intimitet, ku edhe ëndrrave u bëhej autopsi për së gjalli, diçka kjo që i ndodhte një populli të tërë të kthyer në “kufomë social-politike”, nga i cilit kërkohej të shkulej çdo gjë që nuk i shkonte për shtat regjimit, me qëllim që ai të kthehej në një masë amorfe dhe i pa rrezikshëm për pushtetin e kastës.

Për ilustrim, organet e Sigurimit për rrethin e Shkodrës, japin të dhëna përmbledhëse lidhur me luftën ndaj agjitacion-propagandës:

	<u>Të arrestuar</u>	<u>Të këshilluar</u>	<u>Gjithsej</u>
➤ Viti. 1962	20 persona	12 persona	32 persona
➤ Viti. 1963	18 persona	17 persona	35 persona
➤ Viti. 1964	17 persona	85 persona	102 persona
➤ Viti. 1965	27 persona	76 persona	103 persona

Gjithsesi, këto statistika nuk e japin të gjithë kuadrin, sepse, siç dëshmohet në historikun e Sigurimit, niveli iurvejimit/vëzhgimit mbi popullsinë, në kontekstin e ndjekjes së veprimtarisë së agjitacion-propagandës, ishte shumë më i thellë dhe për pasojë edhe i madh.

- Raportimet agjenturiale kundër personave që akuzoheshin për veprimtarinë e agjitacion-propagandës, vetëm për vitin 1965 ishin 5 mijë.

Sipas retorikës që përdorte Sigurimi i Shtetit, armiqtë e tërbuar propagandonin, kundër organizimit kooperativist dhe ekonomisë kooperativiste, çka ndodhte sidomos në fshatra dhe veçanërisht në ata malorë. Burimi kësaj fryme antipushtet ishte nga legatat italiane e jugosllave, nga të riatdhesuarit, turistët, vizitorët, tregtarët (personat e huaj apo vendas që punonin në tregtinë e eksport-importit), grupet e sportistëve, ato kulturore e artistike, shoferët dhe pa harruar klerikët, si dhe, së fundi, nga fund kushdo që mund të kishte kontakt me të gjitha kategoritë e lartpërmendura.

ARRATISJET

Represioni dhe ushtrimi i psikozës së përndjekjes dhe survejimit, si kusht për të parandaluar shfaqjen e çdo lloj pakënaqësie ndaj politikave social-ekonomike dhe regjimit në tërësi, kishte si rezultante përpjekjet e fundit dhe të dëshpëruara të njerëzve, arratisjen.

- Të arratisur, deri në vitin 1965, numëroheshin rreth 790 persona.
Prej tyre, 490 ishin arratisur në/ose nga Jugosllavia, pjesa tjetër në/ose nga vende të tjera.
- Deri në vitin 1976, ky numër arrin në rreth 835 të arratisur, nga të cilët, sipas ndarjeve gjinore, rezultonin 637 burra dhe 198 gra.
- Mosha mesatare deri në vitin 1965: Më shumë se gjysma i takonin moshës 15-25 vjeç.

Sakaq, deri në rënien e sistemit, numri total i të arratisurve është edhe më i madh. Në rastin konkret arratisja nuk vlerësohej si shfaqje dhe shprehje e pakënaqësive për shkak dhe si përgjegjësi e keqqeverisjes, shtypjes dhe mohimit të të drejtave njerëzore që zbatonte regjimi, por si formë armiqësore, çka e bënte dhe e vinte të arratisurin drejtpërdrejt dhe apriori në pozitën e “tradhtarit”, apo të “agjentit e bashkëpunëtorit të agjenturave të huaja”.

Lufta kundër klerit.

Për klerin kishte akuza konstante, veçanërisht ndaj atij katolik, si një autoritet i panënshtuar. Në vijim të këtyre akuzave, pas instalimit të regjimit, përveç goditjeve ndaj eksponentëve drejtues të kishës, autoritetet e kohës kryen edhe vrasjen e burgosjen e dhjetëra e dhjetëra klerikëve. Në vijim dhe deri sa besimi fetar u ndalua, organet e Sigurimit ndiqnin e përndiqnin njerëzit e klerit në mënyrë të organizuar dhe të strukturuar. Në funksion të këtij qëllimi, në vitin 1958 organet e sigurimit pasqyrojnë të dhëna për kontrollin dhe survejimin e klerit katolik në Shkodër. Konkretisht:

Nr. i individëve nën vëzhgim	42 priftërinj	39 murgesha	132 anëtarë të këshillave kishtare
Sipas nivelit të ndjekjes	9- në 2A	17- në 2B	2- në 2A
	17- në 2B		9- në 2B
	1- në P. P. (Përpunim paraprak)		

Struktura e Sigurimit të Shtetit për ndjekjen, survejimin dhe përpunimin përbëhej nga 3 agjentë, 21 informatorë dhe 2 strehues

Kjo strukturë, me të cilën kontrollohej dhe survejohej kleri, konsiderohej e pamjaftueshme dhe për vitin 1958 organet e Sigurimit e forcuan punën dhe veprimtarinë në disa drejtime, siç ishin:

- tërheqja e elementëve të rinj në forcën zbuluese;
- sigurimi i përpunimeve me agjenturë paralele;
- dislokimi i agjenturës zbuluese në institucione kulturore e shkollore, për të tërhequr rininë (në kuptimin për t'i larguar ata nga besimi dhe feja).

Ndërsa, për 5-vjeçarën e parë të viteve 1960, survejimi ndaj klerit vijonte si më poshtë:

Viti	Klerikë në përpunim	Niveli i ndjekjes	Kontingjent
1960	40	9 në 2A	-
1963	47	9 në 2A	233
1964	46	-	270
1965	45	-	-

Për ndjekjen dheurvejimin e klerit në periudhën 1962-1965, kanë qenë angazhuar 33 agjentë dhe 87 bashkëpunëtor të Sigurimit.

Në një kohë kur besimi dhe kleri, i konsideruar si një mish i huaj, në kuptim të organizimit, shtypjes dhe të kontrollit total, i kishte egërsuar organet e sigurimit dhe regjimin në tersi, nën direktivat e udhëheqësit gjithçka do të shkonte drejtë zgjidhjes finale, që do vinte përgjatë vitit 1967, me direktivën dhe aksionin kundër institucioneve të besimit fetar, për t'u finalizuar më pas me ndalimin e besimit, siç u sanksionua në Kushtetutën e vitit 1976, e cila shpalli Shqipërinë vendin e vetëm në ateist botë.

Deri në vitin 1967, kohë kur filloj reprezalja finale mbi objektet e kultit, klerin, dhe besimin, organet e Sigurimit për rrethin e Shkodrës kishin këtë statistikë dhe bilanc.

Objekte kulti	Klerikë në shërbim	Të goditur
81 xhami	66 hoxhallarë	11 priftërinj të arrestuar
73 kisha të besimit katolik	54 priftërinj katolikë	3 të pushkatuar
3 kisha të besimit ortodoks	2 priftërinj ortodoksë	7 të demaskuar
2 teqe	-	
159 objekte kulti gjithsej	122 klerikë gjithsej	

Për gjatë vitit 1967, u prishën pothuaj të gjitha objektet e kultit, ndërsa një pjesë u përshtatën për funksione tjera përdorimi, ndërkohë që vetëm një pjesë e vogël u ruajtën për vlerat muzeore. Ndërsa në lidhje me klerikët, përveç atyre që ishin goditur në formën e vrasjeve e burgosjeve, pjesa tjetër e mbetur u vu nëurvejim/përpunim dhe pothuaj të gjithë më pas iu nënshtuan gjyqeve të popullit.

Kjo është një përmbledhje e cila shpresojmë të prekë sa do pak vëmendjen e atyre që nuk e kanë njohur kurrë atë kohë, ashtu siç shpresojmë që kjo të ngjallë kujtesën e atyre që e kanë jetuar dhe që kanë për të treguar nga ajo kohë. Me qëllim që harresa të mos bëhet kurthi ku të vritet përsëri ajo çfarë ka vlarë diktatura dhe që e shkuara të mos përsëritet më kurrë.